



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

Nr. 1567 Prot.

Patos, më 18.06 /2024



**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 52 datë 18.06 2024

**“PËR**  
**PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E BILETËS SË UDHËTIMIT PËR**  
**PERSONAT ME STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS, ME STATUSIN E TË**  
**VERBËRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK NË LINJËN**  
**E TRASPORTI PUBLIK TË MIRATUAR ME VKB NR. 28, DATË 16.04.2024**  
**PATOS I RI – MUSTAFA MATOHITI - MARGËLLIÇ**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të pikës “n” të nenit 54 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 11 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.3.2012, nenit 11 të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” i ndryshuar me ligjin nr. 9506, datë 03.04.2006, ligjin nr. 27, datë 15.03.2012, ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, nenit 10 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, pikës 7 të kapitullit I të VKM nr. 85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor” ndryshuar me VKM nr. 224, datë 13.4.2022, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e përjashtimit nga pagesa e biletës së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transporti publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti - Margëlliç.

**GRUPI I MENAXHIMIT**

**Sokol Meta**



**Ina Sauli**



**Mimoza Shtëmbari**




**Arben Semanjaku**



**Elda Goxhaj**



**Juela Shpata**



**Astrit Murati**



**Ermenita Mici**



**Erion Hatia**



**Orges Gollosi**



**Alket HALIMI**



**Eneo Xhaferi**



**Arben Shpërdheja**



**Endrit Çako**



**Armando Gushi**



**Florian Kita**



**Blerina LAÇI**



**Barie Goxhaj**



**Nurkë Hazizaj**



**Lindita Pepa**

Adm. Njësia Administrative Zharrëz

Adm. Njësia Administrative Ruzhdije

**Riza Hoxha**



**Agim Mesutaj**







REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE**

Nr. 1587 Prot.

Patos, më 18/06/2024

**RELACION**

**MBI**

**PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E BILETËS SË UDHËTIMIT PËR  
PERSONAT ME STATUSIN E INVALIDIT TË PUNËS, ME STATUSIN E TË  
VERBËRIT, INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK NË LINJËN  
E TRASPORTI PUBLIK TË MIRATUAR ME VKB NR. 28, DATË 16.04.2024  
PATOS I RI – MUSTAFA MATOHITI-MARGËLLIÇ**

Nisur nga kërkesat verbale të grupeve vunerabël, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik për përjashtimin nga pagesa e biletës së udhëtimit për linjën e transportit publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 "Patos i Ri – Mustafa Matohiti - Margëlliç" e cila është funksionale dhe në aktivitet të plotë, pasi janë shqyrtuar të gjitha dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë formën dhe masat e përfitimit të këtyre grupeve, kështu. ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar, në nenin 4 të tij ka përcaktuar se: "Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAP. Pra. bazuar në ligjin e sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për pajisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës, kompetencë që i buron drejtpërdrejtë nga ligji. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit për të udhëtuar pa biletë në transportin urban qytetas, neni 85 i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, parashikon se: "Është e detyrueshme të kryhet perkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta". Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e invalidit të punës, të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin provues specifik. Në këtë kontekst secila shkresë konsiderohet dokument provues, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse VKM nr. 277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10 të tij ka parashikuar se: "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" (i ndryshuar me ligjin



nr. 10/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 37/2014 "Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 21/2013, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003. "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002", ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore". Modeli i librezës së verbërisë, paraplegjikeve dhe tetraplegjikeve përcaktohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër bëhet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbërit të grupit të parë. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për pajisjen e personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. Kështu, ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar, në nenin 4, të tij ka përcaktuar se: "Invalidët pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Dëshmia lëshohet nga Shoqata e Invalidëve të Punës në bazë të KMCAP". Pra, bazuar në ligjin sipërcituar, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për pajisjen e invalidit të punës me dëshminë zyrtare të identifikimit është Shoqata e Invalidëve të Punës, kompetencë që i buron drejtpërdrejtë nga ligji. Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar me gjysëm bilete në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar parashikon se: "Është e detyrueshme të kryhet perkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjies për ta. Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta". Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, invalidëve të punës, invalideve paraplegjike dhe tetraplegjike, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin provues specifik. Në këtë kontekst, VKM nr. 277, datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: " Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë.

Për sa s'qaruar më sipër kemi propozuar miratimin për perjashtimin nga pagesa e biletës së udhëtimit për personat me statusin e invalidit të punës, me statusin e të verbërit, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik në linjën e transporti publik të miratuar me VKB nr. 28, datë 16.04.2024 Patos i Ri – Mustafa Matohiti - Margëllic.

Për përfitimin e këtyre lehtësirave kategoritë e personave të përcaktuar në projektvendim, duhet të jenë të pajisur me:

- Invalidët e punës të jenë të pajisur me KMCAP dhe Libreza Invalidi të lëshuar nga Shoqatat në të cilën ata janë anëtar.

- Të verbërit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët të jenë të pajisur me KMCAP, Libreza të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vetëm pas paraqitjes së këtyre dokumentave pranë faturistëve apo shoferëve të linjes do të merret masa e përfitimit.

Drejtori të Ardhurave Vendore  
Çajup Refitaj



**KRYETARI**  
**Fation Duro**

